

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 214 Prot.

Tiranë, më 08.03 2016

VENDIM Nr. 14, datë 29.02.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 29.02.2016, pasi Relacionin mbi verifikimit të terren, në kuadër të projektit "Porti i Jahteve, Kalaja e Turrës", Synej - Kavajë, realizuar nga ASHA dhe Koncepti kryerjes së sondazheve arkeologjike, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

- I. Për punimet e realizuara pa leje nga subjekti "FINSEC PORT" sh.a., DRKË Durrës bazuar në Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), neni 49, të marrë masa të menjëherëshme për zbatimin e sanksioneve përkatëse për kundërvajtjet administrative të kryera nga ky subjekt.
- II. Të kryhet nga subjekt i licencuar në arkeologji, gërmimi arkeologjik i shpëtimit, i varrit të periudhës së Antikitetit të Vonë, i zbuluar si rezultat i punimeve për zgjerimin e rrugës ndihmëse dhe dokumentimin e tij, pasi të jetë miratuar më parë koncepti i gërmimit arkeologjik të shpëtimit në KKA.
- III. Të miratojë Konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji znj. Lida Miraj, duke përcaktuar realizimin e sondazheve me përmasa 2m x 2m, në zonën e parashikuar për ndërtimin e objekteve 3 kat.
- IV. Subjekti "FINSEC PORT" sh.a., i cili po zbaton punimet e ndërtimit të projektit të sipërpërmendur, duhet të lidhë paraprakisht kontratë trepalëshe me subjektin e licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet dhe gërmimin arkeologjik të shpëtimit, të varrit të periudhës së Antikitetit të Vonë dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre. Raporti me rezultatet e tyre të paraqitet në KKA e radhës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO